



**Terre des hommes**

**Ndihmë për fëmijët.**



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*  
*Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*  
*Ministarstvo Rada i Socijalne Zastite*  
*Ministry of Labour and Social Welfare*

**Udhëzuesi për menaxhimin  
e rasteve për qëllim të  
mbrojtjes së fëmijës gjatë  
pandemisë  
me COVID-19 në Kosovë**

## **Hyrje:**

Ky dokument synon t'u sigurojë profesionistëve në fushën e mbrojtjes së fëmijëve udhëzime se si të përfshihen në proceset e menaxhimit të rasteve në përgjigje të shpërthimit të pandemisë me virusin COVID-19 dhe të kuptojnë më mirë rolin e rëndësishëm të akterëve socialë në raste urgjente. Situatat e urgjencës ndikojnë në shumë aspekte të menaxhimit tradicional të rasteve siç janë këshillimi ballë për ballë dhe referimet në kohë të përgjegjshme si dhe ofrimi i shërbimeve. Sidoqoftë, menaxhimi i rasteve me qëllim mbrojtjen e fëmijës është pjesë e shërbimeve thelbësore që nuk mund të ndalen papritmas dhe kërkon përshtatje graduale me urgjencën e re.

## Konteksti:

Qeveria e Kosovës në vazhdimësi është duke miratuar masa të reja me qëllim të parandalimit të përhapjes së infeksionit me virusin COVID-19, masa të cilat kanë ndikim edhe në punën dhe ofrimin e shërbimeve sociale. Disa prej masave kryesore janë: reduktimi i punonjësve në administratë vetëm në staf esencial dhe angazhimi i tyre me punë nga shtëpia (online), përgjysmimi i personave në secilën zyrë në përputhje me manualin; mbyllja e zyrave apo njësive në të gjitha institucionet publike dhe bizneset private ku ka raste pozitive; bartja e maskave dhe respektimi i distancës fizike është obligative, etj.

Situata e krijuar me përhapjen e pandemisë ka vështirësuar dhe ka ndryshuar edhe mënyrën e ofrimit të shërbimeve sociale në Kosovë. Qendrat për Punë Sociale e kanë modifikuar orarin e punës dhe punojnë me një numër të kufizuar të punonjësve socialë dhe aktualisht ofrojnë vetëm shërbime minimale për rastet e abuzimit, rastet në gjykata, intervistat në stacionin policor ose ofrimin e ndihmave emergjente kur kërkohet. Sipas raportimeve, pandemia e ka vështirësuar procesin e identifikimit të rasteve në rrezik apo atyre që kanë nevojë për mbështetje. Për më tepër, të dhënat tregojnë se numri i referimit të rasteve në Qendrat për Punë Sociale ka rënë dukshëm. Megjithatë, edhe rastet të cilat janë në proces të menaxhimit hasën në vështirësi për shkak të numrit të limituar të punëtorëve socialë, që e bënë të pamundur plotësimin e nevojave të gjitha kategorive sociale në Kosovë. Në anën tjetër, edhe shumë OJQ si ofruese të shërbimeve i kanë pezulluar përkohësisht aktivitetet apo ofrimin e shërbimeve, duke lënë kështu një boshllëk në sistemin e ofrimit të shërbimeve.

## I. Reagim në menaxhim të rastit:

---

Për shkak të situatës pandemike dhe kërkesave për parandalim dhe kontroll të infeksionit, është e vështirë të ndiqen rastet në mënyrë të rëndomtë duke kryer vizita në shtëpi dhe takime ballë për ballë. Duke marrë parasysh situatën, profesionistët mund të adoptojnë modalitete të reja duke ndjekur udhëzimet kryesore. Të gjitha tryezat e rrumbullakëta multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rasteve (TNMR)<sup>1</sup> duhet t'i rishikojnë çështjet e tyre ekzistuese për të siguruar që atributi i nivelit të rrezikut është i përshtatshëm dhe duhet të prioritizojnë raste të nivelit më të lartë të rrezikut, si dhe detyra të tjera thelbësore që duhet të vazhdojnë. Për më tepër, është e nevojshme që i gjithë procesi në reagim të menaxhimit të rasteve të realizohet duket zbatuar në përpikëri edhe vendimet e Qeverisë dhe obligimet nga Manuali për institucionet publike dhe private në Kosovë me gjitha udhëzimet e tij.<sup>2</sup>

- Strategjitë duhet të miratohen nga ekipet e menaxhimit të rasteve (MR-ve) në përputhje me situatën dhe kushtet e punës për të siguruar që personave më të rrezikuar u vazhdohet përcjellja e rastit dhe ofrimi i mbështetjes në varësi të nivelit të prioritetit dhe natyrës së shqetësimeve ndaj mbrojtjes.
- Menaxheri i rastit brenda QPS-së duhet të sigurojë që vendimet bazohen në qasjen që e ka fëmijën në qendër të fokusit, e ku mbizotëron interesi më i mirë i fëmijës.<sup>3</sup>
- Material i mjaftueshëm dhe i duhur në fushën e mbrojtës duhet të jetë në dispozicion, ose nëse është e mundur, për të bërë përcjelljen personalisht duke respektuar masat për distancë sociale, dhe parandalim dhe kontroll të infeksionit (PKI), dhe nëse konteksti lejon: vizita ballë për ballë duhet të realizohen kudo që është e mundur për rastet më delikate.
- Nëse nuk ka mbrojtje në dispozicion për rastet, ose kufizim të plotë (karantinë) në kontekst, duhet bërë tranzicioni i përcjelljes nga distanca: telefon (nëse telefonat e mençur dhe interneti janë në dispozicion, duhet të mbizotërojë mundësia për videokonferenca ose mundësitë tjera përmes telefonit).
- Rastet me rrezikshmëri të ulët dhe të mesme duhet të rishikohen dhe prioritetet e nevojave përcjellëse duhet të përcaktohen, duke siguruar disponueshmërinë e punëtorëve të rastit në rast nevojë (kontakti), përcjelljen përmes telefonit nëse kërkohet, dhe shqyrtimin e përkrahjes së sigurt të komunitetit dhe opsionet tjera vijuese.
- Rastet me rrezikshmëri të lartë: Prioritet duhet t'u jepet fëmijëve që janë të ndarë nga kujdestarët e tyre, përfshirë ata në qendrat e vëzhgimit, qendrat e trajtimit ose kujdesin alternativ; fëmijëve në familjet e prekura nga kufizimet e lëvizjes ose mungesa e qasjes në shërbime; fëmijëve me aftësi të kufizuara, sëmundje kronike, fëmijëve viktime dhe të mbijetuarve të sëmundjes të cilët mund të refuzohen nga familjet e tyre; dhe fëmijëve me familjarë ose anëtarë të shtëpisë të prekur nga sëmundja.<sup>4</sup>

---

<sup>1</sup>TNMR-të funksionojnë bazuar në një rregullore të brendshme që përpilohet dhe miratohet nga anëtarët e grupit ndërsektorial.

<sup>2</sup>Shih Manualin për mbrojtje nga përhapja e virusit COVID-19 të hartuar nga Ministria e Shëndetësisë:

<https://msh.rks-gov.net/ep-content/uploads/2020/06/Manual-p%C3%ABr-parandalimin-dhe-luftimin-e-COVID19.pdf>

<sup>3</sup>Shih Protokollin e punës për bashkëpunimin ndërsektorial në mbrojtjen e fëmijëve.

<sup>4</sup>Ju lutemi shikoni aneksin 1 tabelë në lidhje me rrezikun e mbrojtjes së fëmijëve dhe shqetësimet e rasteve të krijuara nga COVID-19 me sugjerime të dhëna për veprimet e marra me prioritet, masat zbutëse dhe qasjet e miratuara bazuar në 7 dimensione/kategori të lidhura.

## II. Procesi i menaxhimit të rastit:

---

Hapat e menaxhimit të rasteve, parimet dhe procedurat e qarta janë mjete thelbësore<sup>5</sup> që duhen ndjekur gjatë urgjencës shëndetësore me Covid-19. Parimet dhe hapat mbetën të pandryshuar, megjithatë qasja dhe modalitetet për secilin hap mund të rishikohen për një proces më fleksibël dhe të adaptuar:

- Regjistrimi dhe vlerësimi: rishikoni informacionin përkatës dhe thelbësor që duhet të mblidhet;
- Plani i rastit: veprime të menaxhimit të çështjeve thelbësore, por dinjitoze (duke respektuar parimet e MR-së). Në fazën e përgatitjes, siguroni një plan sigurie në rast të izolimit për rastet në rrezik;
- Përcjellja e rasteve të fëmijëve në rrezik për abuzim, trafikim, neglizhencë me rrezikshmëri të mesme/të lartë përmes Menaxherit të rasteve të QPS-së dhe anëtarëve të TNMR-së;
- Për raste që e kanë të domosdoshme vendosjen në strehim rezidencial, nëse është e mundur, të bëhet një ekzaminim mjekësor apo edhe testim për COVID-19, nëse shfaqet nevoja, me qëllim të parandalimit të përhapjes së virusit.
- Pëlqimi i bazuar në informim të mirëfilltë dhe pjesëmarrja në vendimmarrje: nëse kërkohet, hulumtoni alternativën për të marrë pëlqimin e bazuar në informim të mirëfilltë ose për të mbledhur pikëpamje dhe vendimmarrje pjesëmarrëse nga distanca (thirrjet telefonike të regjistruara);
- Rritja e shkëmbimit të informacionit për referime dhe shërbime të tjera mbështetëse të mundshme për fëmijët;
- Angazhoni fëmijët, veçanërisht adoleshentët, në vlerësimin se si COVID-19 prek ata në mënyra të ndryshme për të informuar programimin dhe avokatinë;
- Siguroni ndihmë financiare dhe materiale për familjet të cilat janë prekur sa i përket mundësive për gjenerimin e të ardhurave;
- Vendosni masa konkrete për të parandaluar ndarjen fëmijë-familje dhe siguroni mbështetje për fëmijët e mbetur vetëm pa kujdes të duhur për shkak të shtrimit në spital ose vdekjes së një prindi ose kujdestari;
- Mbyllja e rastit: në varësi të kontekstit, merrni parasysh mbylljen ose mbylljen e përkohshme të rasteve (në pritje) me rrezikshmëri të ulët që nuk kërkojnë përcjellje të rregullt.

---

<sup>5</sup>Ju lutemi shikoni standardet minimale të hartuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

### III .Forcimi i sistemit të mbrojtjes së fëmijëve si dhe bashkëpunimi dhe koordinimi

---

Është me rëndësi thelbësore të forcohet sistemi i mbrojtjes së fëmijëve gjatë urgjencës pandemike. Situata pandemike mund të kërkojë rishikimin e rrugëve ekzistuese të referimit dhe hartës së shërbimeve në nivelin komunal dhe atë kombëtar.

- Mbështetni vendosjen e lidhjes midis shërbimeve shëndetësore dhe atyre sociale në nivel kombëtar dhe atë komunal, për të vendosur një reagim specifik të menaxhimit të rastit me qëllim të mbrojtjes së fëmijëve nga rreziqet dhe shqetësimet e krijuara nga COVID-19, duke identifikuar dhe ofruar shërbime të mbrojtjes për fëmijët e mbetur pa kujdestarin për shkak të shtrimit në spital ose vdekjes së prindit ose kujdestarit.
- Koordinoni dhe mbështetni ofrimin e shërbimeve të mbrojtjes sociale për familjet e cenueshme dhe ekonomikisht të prekura nga COVID-19.
- Gjersa situata evoluon, qasja dhe ofrimi i shërbimeve mund të ndryshojë, gjithashtu, mund të krijohen shërbime të reja shëndetësore.
- Akterët socialë duhet të identifikojnë cilat shërbime mund të ndikohen nëse qasja në komunitetet e prekura është e kufizuar (përfshirë shëndetësinë, sanitarinë dhe mbrojtjen etj.).
- Përditësoni hartën e shërbimeve dhe azhurnoni shërbime specifike të MF-së (mbrojtjes së fëmijës) që mund të kërkojnë më shumë gjatë COVID-19 (kujdes shëndetësor, kujdes alternativ, shërbime mbështetëse me bazë në komunitet, ndihmë sociale apo sanitare, ushqim etj.).
- Monitoroni ndryshimet në shërbime dhe informoni stafin e menaxhimit të rasteve, pikat e kontaktit për MF-në me bazë në komunitet<sup>6</sup> dhe të komunitetit ku është e mundur.
- Rishikoni të gjitha vendet ku ekzistojnë shërbime të menaxhimit të rasteve dhe identifikoni seritë ekzistuese të mbështetjes në bazë të komunitetit ose pikat e kontaktit (udhëheqësit e komunitetit), ose nëse është e mundur dhe e nevojshme, identifikoni pika të reja kontakti.
- Koordinimi i përbashkët midis punëtorëve socialë dhe akterëve shëndetësorë është jetik për t'iu përgjigjur në mënyrë të duhur dhe në kohë çështjeve të MF-së dhe rreziqeve të krijuara nga COVID-19.
- Koordinimi i përbashkët ndërsektorial në nivelin lokal është i nevojshëm për të zbatuar një qasje gjithëpërfshirëse. Kështu, mbledhja e TNMR-ve duhet të mbahet rregullisht për të siguruar shkëmbimin efektiv të informacionit, koordinimin dhe përgjigjen e përbashkët.

---

<sup>6</sup>Pikat kontaktuese mund të jenë udhëheqës të komunitetit ose përfaqësues të OJQ-ve lokale.

## IV. Kujdesi për personelin dhe ngritja e kapaciteteve:

---

- Punëtorët socialë dhe profesionistët e tjerë të përfshirë në menaxhimin e rasteve duhet të ndërmarrin gjithmonë masa të duhura parandaluese dhe të ndjekin rekomandimet e dhëna nga institucioni shëndetësor i Kosovës<sup>7</sup>.
- Shpjegoni distancimin social përmes një komunikimi të vëmendshëm - kjo do të thotë të shpjegoni pse distanca sociale është e rëndësishme për të mbrojtur fëmijën dhe familjen si dhe punëtorin social gjatë COVID-19.
- Asnjë shtrëngim duarsh gjatë vizitës - ju lutemi sqaroni fëmijës dhe familjes me mirësi pse këto janë masa të nevojshme për t'u ndërmarrë.
- Mbajeni maskën dhe promovoni distancën sociale - mbani një ose dy metra distancë me fëmijën dhe sigurohuni që vizita të kryhet në një dhomë të ventiluar ose hapësirë të hapur e të sigurt.
- Nëse një punëtor social ose ndonjë profesionist tjetër ndjen ndonjë nga simptomat e COVID-19, ai/ajo nuk duhet të largohet nga shtëpia e vet, duhet të informojë mbikëqyrësin e vet dhe duhet të thërrasë familjen për t'u thënë arsyen pse nuk do të vijë.
- Në rastet kur familja i kërkon punëtorit social të mos kryejë vizitë në shtëpi për shkak të shqetësimeve në lidhje me transmetimin e COVID-19, punëtori social duhet të jetë mirëkuptues, t'i shtyjë vizitat dhe të përpiqet të bënë përcjelljen e duhur përmes telefonit.
- Sigurimi që profesionistët që punojnë me raste të ndjehen sa më të sigurt (siguria fizike dhe emocionale) është thelbësor për të ofruar shërbime thelbësore për përfituesit. Nëse është e nevojshme, siguroni mbështetje psikologjike për ta<sup>8</sup>.

## Ngritja e kapaciteteve, trajnimi dhe mbikëqyrja:

- Eksploroni mjetet e duhura për stërvitje dhe mbikëqyrje në distancë si dhe për shkëmbim informacioni mes punëtorëve sociale dhe mbështetje mes kolegëve: mjete dhe platforma online dhe digjitale (Skype, WhatsApp, Viber, Zoom) ose thirrje telefonike.
- Përdorni Child Protection Hub<sup>9</sup> për të eksploruar mundësitë e mësimit elektronik për punonjësit profesionistë të mbrojtjes së fëmijëve gjatë izolimit dhe punës në distancë.

---

<sup>7</sup> Ndiqni masat parandaluese të dhëna nga Ministria e Shëndetësisë: <https://kosova.health/masat>

<sup>8</sup> Departamenti i Psikologjisë i Universitetit të Prishtinës filloi një faqe në internet për çështjet e shëndetit mendor gjatë COVID-19: <https://shendetimendor.uni-pr.edu/hospitalList.html>

<sup>9</sup> The Child Protection Hub është një platformë rajonale që bashkon profesionistë për mbrojtjen e fëmijëve, ku ata mund të shkëmbejnë përvoja dhe njohuri, të mësojnë nga njëri-tjetri si të ofrojnë dhe të marrin mbështetje. Linku: <https://childhub.org/sq>

## V. Menaxhimi i informacionit dhe mbrojtja e privatësisë së të dhënave:

---

- Siguroni vetëm formularin e nevojshëm për menaxhimin e rasteve dhe që informacioni relevant të jetë i regjistruar.
- Rishikoni dhe përshtatni formularin e referimit ndërinstitucional dhe siguroni që sektori shëndetësor dhe stafi të jenë të informuar në lidhje me të. Sidoqoftë, nëse nuk ekziston një sistem referimi, lehtësoni dhe thjeshtësoni referimet e shpejta nga personeli shëndetësor (punëtorët socialë plotësojnë formularin e referimit për secilin rast për t'i mbajtur gjurmët).
- Mbrojtja e privatësisë së të dhënave është thelbësore në kontekstin e një epidemie. Shkeljet mund të çojnë në rreziqe siç janë stigmatizimi, refuzimi shoqëror, izolimi, etj.

## VI. Monitorimi, vlerësimi, përgjegjësia dhe mësimi

---

- Për qëllime monitorimi, mund të jetë e dobishme të ndani analizën e të dhënave të MF-së dhe trendet e ngarkesave të reja të krijuara që nga fillimi i epidemisë në vend.
- Siguroni sa më shumë informacione që të jetë e mundur, përpiloni të gjitha alternativat pozitive të gjetura, metodat dhe qasjet e zhvilluara ose praktikatat jo të mira. Mbani shënime dhe mësoni rreth pandemisë.



## Aneksi 1 | Rreziqet dhe shqetësimet për mbrojtjen e fëmijëve në lidhje me COVID-19

SHQETËSIMET LIDHUR ME MBROJTJEN E FËMIJËVE	REZIQET E GJENERUARA NGA COVID-19	VEPRIMET PRIORITARE TË SUGJERUARA, MASAT LEHTËSUESE DHE QASJA E ADAPTUAR
<p><b>Ndarja e fëmijëve nga kujdestarët</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sëmundja dhe/ose shtrimi në spital i kujdestarit/-ëve</li> <li>• Vdekja e kujdestarit</li> <li>• Fëmijët e dërguar nga prindërit për të qëndruar me familjen tjetër në zona jo të prekura</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Koordinimi i profesionistëve në menaxhimin e rasteve me sektorin e shëndetësisë për të përshtatur metodën e referimit (punëtori social, mbrojtësi i viktimës, zyrtari i shërbimit sprovuës, mësuesi, psikologu, etj.)</li> <li>• Trajnim/ngritje e vetëdijes së stafit të kujdesit shëndetësor/Oendrave të Mjekësisë Familjare në lidhje me rreziqet dhe aktivitetet për mbrojtje (për shembull duke përdorur përbajtjen e këtij udhëzimi) dhe krijimin e mënyrave dhe mjeteve të referimit.</li> <li>• Lehtësoni kontaktin e fëmijëve dhe kujdestarëve gjatë ndarjes (shtrimit në spital ose fëmijët me anëtarët e tjerë të familjes), përmes mjeteve të adaptuara: thirrje telefonike, videokonferencë përmes tabletëve ose telefonave të mençur kur është e mundur, videomesazhe të incizuara</li> <li>• Mundësoni kontaktet e fëmijëve të vendosur në strehim rezidencial me familjarët e tyre përmes thirrjeve telefonike përmes tabletëve, telefonave të mençur, ose videomesazheve të incizuara.</li> <li>• Azhurnoni dhe hartëzoni të gjitha shërbimet alternative të kujdesit në dispozicion (zyrtare dhe jozyrtare) në koordinim me akterët e tjerë dhe përshtatni protokollet (të lidhur me udhëzimet e qeverisë kombëtare) për të siguruar kujdes të sigurt alternativ për fëmijët e ndarë nga familjet e tyre.</li> <li>• Siguroni një ekzaminim mjekësor për vlerësim të gjendjes së përgjithshme për rastet që kanë nevojë për vendosje në strehimore.</li> <li>• Siguroni koordinimin me shërbimet sociale për të eksploruar dhe përshtatur zgjidhje alternative afatgjata të kujdesit për fëmijët jetimë.</li> </ul>
<p><b>Shqetësimi psikosocial</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Frika nga infektimi me sëmundjen</li> <li>• Stigmatizimi i individëve të infektuar me sëmundje ose që dyshohet të jenë të infektuar</li> <li>• Vdekja ose sëmundja e anëtarëve të familjes, miqve dhe fqinjëve</li> <li>• Ndarja e familjes</li> <li>• Frustrimi dhe shqetësimi i kujdestarëve për shkak të pamundësisë për të përbushur rolet dhe përgjegjësitë, rritja e rreziqeve të agresivitetit, menaxhimi i zemërimit dhe dhunës në familje</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Koordinohuni me Ministrinë e Shëndetësisë, Institutin e Shëndetit Publik dhe Departamentin e Psikologjisë për të shpërndarë informacionet e nevojshme për reagimet normale ndaj situatave stresuese si dhe strategjitë, teknikat dhe mesazhet pozitive të përballimit.</li> <li>• Azhurnoni hartëzimin e shërbimeve ShMPPS, me vëmendje të veçantë për shërbimet brenda ose afër nga institucionet e kujdesit shëndetësor, ose ekipet e lëvizshme.</li> <li>• Udhëheqësit e TNMR-ve duhet të përfshijnë Qendrat Mjekësisë Familjare në konsultime dhe të shërbejnë si një urë për t'i adresuar rastet.</li> </ul>
<p><b>Abuzimi (fizik, emocional)</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Humbja e të ardhurave ekonomike për shkak të vdekjes ose sëmundjes së kujdestarit rrit tensionet brenda familjes, zhgënjimin dhe shqetësimin e kujdestarëve për shkak të pamundësisë për të përbushur rolet dhe përgjegjësitë, duke rritur rreziqet e agresivitetit, menaxhimin e zemërimit, sjelljet abuzive dhe dhunën në familje</li> <li>• Frika nga transmetimi/bartja e virusit, nevoja për t'u kujdesur për anëtarët e sëmurë të familjes ose paaftësia e prindërve për të përballuar shqetësimet psikosociale të fëmijëve</li> <li>• Ndarja nga kujdestarët/anëtarët e familjes tashmë abuzivë ose nga mjedisi i dhunës brenda familjes</li> </ul>	<p>Punëtorët socialë dhe punonjësit e tjerë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve duhet të identifikojnë dhe hartëzojnë fëmijët, familjet dhe njësitë familjare më të cenuara dhe të hartojnë një strategji të koordinuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• për të siguruar përcjelljen e duhur (nga distanca ose me prezencë fizike, në varësi të rreziqeve në kontekstin aktual dhe respektimit të masave dhe mbrojtjes personale të stafit dhe përfituesve)</li> <li>• për të siguruar qasjen e tyre në nevojat themelore (ushqim, qasje në institucionet e kujdesit shëndetësor dhe/ose ndihmë sociale)</li> <li>• nëse kufizimi është i detyrueshëm dhe qasja për akterët e MF-së është i kufizuar, për të koordinuar ndihmën më të përshtatshme në distancë të MR-së me akterët e tjerë dhe për të planifikuar buxhetin për mjetet e kërkuara (tabletë, telefona të mençur, telefona ...)</li> <li>• për t'i eksploruar opsionet për krijimin e një linje telefonike mbrojtëse ku fëmijët, të rinjtë ose familjet mund të kenë qasje tek profesionistët për mbështetje.</li> <li>• për të siguruar koordinimin me sektorin e shëndetësisë në mënyrë që të sigurohet trajtimi i rasteve që janë të vendosura në kujdes rezidencial dhe të cilat kanë shqetësime shëndetësore.</li> </ul>

<p><b>Dhuna mbi baza seksuale dhe gjinore (DhBSGj)</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndarja nga kujdestarët abuzivë/anëtarët e familjes ose brenda mjedisit të dhunës në familje mbi baza gjinore</li> <li>• Mbrojtja e familjes e zvogëluar për shkak të vdekjes ose sëmundjes së kujdestarit</li> </ul>	<p>Koordinohuni me akterët e MF-së dhe DhBSGj-së (dhe sistemin e shërbimeve sociale nëse është funksional) për të identifikuar dhe hartëzuar fëmijët, familjet dhe njësitë familjare më të rrezikuara dhe për të zhvilluar një strategji të koordinuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• për të siguruar përcjelljen e duhur (nga distanca ose me prezencë fizike, në varësi të rreziqeve në kontekstin aktual dhe respektimit të masave të PKI-së dhe mbrojtjes personale të stafit dhe përfituesve)</li> <li>• për të siguruar qasjen e tyre në nevojat themelore (gjëra joushimore, ushqim, qasje në institucionet e kujdesit shëndetësor dhe/ose ndihmë në para/kuponë)</li> <li>• nëse kufizimi është i detyrueshëm dhe qasja për akterët e MF-së është e kufizuar, për të koordinuar ndihmën më të përshtatshme në distancë të MR-së me akterët e tjerë dhe për të planifikuar buxhetin për mjetet e kërkuara (tabletë, telefona të mençur, telefona ...)</li> <li>• për të eksploruar opsionet për krijimin e një linje telefonike mbrojtëse ku fëmijët ose të rinjtë që mbijetojnë ose janë në rrezik mund të arrijnë profesionistët për mbështetje.</li> </ul>
<p><b>Neglizhenca</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Fëmijët nuk marrin stimulim të rregullt dhe të duhur për zhvillimin e tyre kognitiv, social dhe emocional gjatë sëmundjes (duke qenë i sëmurë nga fëmija ose kujdestari) ose gjatë izolimit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Koordinohuni me akterët e shëndetit mendor dhe psikik (ShMPPS) për të shpërndarë mesazhe dhe aktivitete në shtëpi për stimulimin e fëmijëve, aktivitetet familjare dhe përkrahjen e ndërsjellë për të forcuar lidhjet, teknikat e relaksimit, mekanizmat pozitivë të përballimit dhe reagimet normative ndaj situatës stresuese.</li> <li>• Koordinohuni me akterët shëndetësorë dhe institucionet e kujdesit (përmes pranisë së ShMPPS dhe/ose stafit të punës sociale brenda institucioneve të kujdesit shëndetësor, ose përmes trajnimeve për stafin e kujdesit shëndetësor dhe sigurimit të materialeve) për të siguruar shtrimin në spital sa më miqësor për fëmijët: <ul style="list-style-type: none"> <li>- aktivitete stimuluese për fëmijët e vegjël</li> <li>- aktivitete individuale për fëmijët më të rritur (materiale për të shkruar, vizatuar ...)</li> </ul> </li> </ul>
<p><b>Përgjashtimi social</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Stigmatizimi social i individëve të infektuar ose i personave që dyshohet të jenë të infektuar</li> <li>• Dështimi për të mbrojtur të drejtën e intimitetit nga akterët shëndetësorë dhe/ose të fushës së mbrojtjes, duke ekspozuar fëmijët dhe familjet me sëmundje</li> <li>• Rritja e përgjashtimit social të grupeve të cënueshme (emigrantët, refugjatët, grupet etnike minoritare, fëmijët në rrugë, fëmijët në konflikt me ligjin, familjet me fëmijë kryefamiljar ...) që nuk kanë qasje në informacionin e duhur, kujdesin shëndetësor dhe përcjelljen mund të çojë në rritje të rreziqeve të ekspozimit dhe kontaminimit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Siguroni respektim të rreptë të konfidencialitetit dhe të drejtës së privatësisë (referojuni MR dhe protokolleve të mbrojtjes së të dhënave shëndetësore nëse ekzistojnë)</li> <li>• Koordinohuni me akterët e MF-së, ShMPPS-së dhe të shëndetësisë për të shpërndarë informacionin e duhur në lidhje me rreziqet e kontaminimit real, masat parandaluese dhe përhapjen e thashethemeve.</li> <li>• Koordinohuni me akterët e MF-së dhe shërbimet sociale për të identifikuar dhe hartëzuar grupet më të rrezikuara dhe për të zhvilluar një strategji të koordinuar: <ul style="list-style-type: none"> <li>- për të siguruar monitorimin e mbrojtjes sa herë të jetë e mundur (kontaktet, vizitat) dhe respektimin e masave të KPI-së dhe mbrojtjes së stafit dhe përfituesve</li> <li>- nëse është e pamundur të qasni tek grupe të cënueshme, për të hulumtuar opsionet e monitorimit në distancë (siguroni telefona ose pajisje të tjera të sigurta të komunikimit nëse është e mundur para kufizimit të qasjes, krijoni një linjë telefonike për t'ua mundësuar fëmijëve, të rinjve dhe familjeve të kërkojnë ndihmë në rast nevoje)</li> <li>për të siguruar koordinimin me sektorin e shëndetësisë në mënyrë që t'i kushtohet vëmendje e veçantë qasjes së grupeve të cënueshme në institucionet e kujdesit shëndetësor që adresojnë pengesat specifike për secilin nga grupet në varësi të kontekstit.</li> </ul> </li> </ul>
<p><b>Puna e rrezikshme e fëmijëve</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Humbja e të ardhurave financiare për shkak të vdekjes ose sëmundjes së kujdestarit/shtylla e familjes</li> <li>• Familjet me fëmijë kryefamiljarë dhe fëmijët në rrugë pa mbështetje, kujdes dhe përcjellje do të vazhdojnë punën joformale për të mbuluar nevojat themelore, në rrezik të lartë të infeksionit dhe kontaminimit.</li> </ul>	<p>Koordinohuni me akterët e MF-së (dhe sistemin e shërbimeve sociale të MF-së nëse është funksional) për të identifikuar dhe hartëzuar shumicën e fëmijëve dhe të rinjve në rrezik si dhe familjet më të prekshme, si dhe hartoni një strategji të koordinuar për të siguruar monitorim nga distanca dhe qasje në nevojat themelore kur të jetë e nevojshme (ushqim, qasje në institucionet e kujdesit shëndetësor dhe/ose ndihmë në para/kuponë).</p>

## Aneksi 2 | Nivelet e rreziqeve

<b>Nivelet e rreziqeve</b>	Në rast se nuk ka indikacion të COVID-19 në familje ose në komunitetin e ngushtë	Në rast se ka konfirmim të COVID-19 në familje ose komunitet të ngushtë - bazuar në udhëzimet e Qeverisë së Kosovës
<b>I ulët</b>	Përmes telefonit	Përmes telefonit
<b>I mesëm</b>	Vizitë me masa të duhura parandaluese	Përmes telefonit, kontakte ditore për të siguruar që fëmija/familja është mirë. Në momentin kur familja testohet negativ nga akterët shëndetësorë, punëtori social bën vizitë të menjëhershme.
<b>I lartë</b>	Vizitë me masa të duhura parandaluese	Përmes telefonit, kontakte ditore për të siguruar që fëmija/familja është mirë. Në momentin kur familja testohet negativ nga akterët shëndetësorë, punëtori social bën vizitë të menjëhershme.

## Aneksi 3 | Kontaktet urgjente dhe shërbimet e informacionit

---

### Për simptoma ose raste të dyshuara të COVID-19

Numri kontaktues: 038 200 80 800 ose vizitoni uebfaqen: <https://kosova.health/>

### Përditësimet e informacionit në lidhje me situatën e COVID-19 në nivel kombëtar

Vizitoni uebfaqen e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik: <http://niph-rks.org/>

### Numri i linjës për të raportuar rastet e dhunës në familje dhe trafikimit të qenieve njerëzore:

Numri pa pagesë: 0800 1111 2

### Informacion në lidhje me shëndetin mendor gjatë COVID-19

<https://shendetimendor.uni-pr.edu/#seancat>

### Trajnim përmes platformave digjitale dhe uebinareve

<https://childhub.org/sq>